VENDIM
Nr. 832, datë 15.9.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 229, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT ZYRTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 2 dhe 49, pika 1 të ligjit nr. 9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1.18 të kapitullit III "Simbolet e Republikës", të ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë, bashkëlidhur vendimit nr. 229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët "…vendoset portreti i Presidentit të Republikës" zëvendësohen me "…vendoset portreti i themeluesit të shtetit modern shqiptar, Ismail Qemali, që i bashkëlidhet këtij akti".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama